



REPUBLIKA E MAQEDONIS SË VERIUT
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 dhe nenit 23 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 12/2019) neni 36 paragrafi 1 dhe neni 40 dhe 41 të Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, KSHPK duke vepruar në bazë të denoncimit nga parashtruesi i njohur, në vazhdimin e seancës së 51-të, të mbajtur më datë 01.09.2021 morri,

VENDIM

Denoncimi për korrupsion nr. 12-2150 / 1, datë 08.06.2021 nga parashtruesi i njohur -----
-----, REFUZOHET.

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit nuk ka kompetencë - nuk ka elemente për veprimin e tij të mëtejshëm kompetent në lëndën me numër 12-2150/1 të vitit 2021 i formuar në bazë të denoncimit - Kundërshtimit me nr. 12-2150/1 të datës 08.06.2021.

Lënda me numër 12 -2150 e vitit 2021 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e internetit të Komisionit Shtetëror brenda 5 (pesë) ditëve nga miratimi i tij.

Kopje nga vendimi të dorëzohet deri te parashtruesi i denoncimit.

Arsyetim

Lënda me numër 12-2150 nga 2021 është formuar në bazë të denoncimit - Kundërshtimi me numër 12-2150 / 1 nga 08.06.2021, nga parashtruesi i njohur ----- me vendbanim në Komunë -----, dhe u dorëzua përmes Arkivave të Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit.

Në denoncim, parashtruesi vë në dukje një problem personal në lidhje me llogarinë e tij personale të transaksionit, për të cilin, siç deklaron në kërkesë, është bllokuar për 25 vjet për shkak të një borxhi sipas lëndës me nr. ----- që nga viti 2001. Parashtruesi gjithashtu deklaron se si një ish përfitues i ndihmës financiare sociale, dhe tani një përfitues aktual i një pensioni pleqërie, për shkak të bllokimit të llogarisë së transaksionit ai nuk është në gjendje të hyjë dhe të përdorë fondet që i paguhen rregullisht çdo muaj.

Nga dëshmitë e paraqitura nga parashtruesi përveç kërkesës mund të shihet se ai me Certifikatën e miratimit të ndihmës juridike dytësore, të lëshuar nga Ministria e Drejtësisë-Zyra Rajonale -----, siguroi të drejtën ndihmës juridike dytësore për përfaqësim në procedurën para bankës kompetente për zhbllokimin e llogarisë së tij personale të transaksionit me qëllim sigurimin e kushteve për marrjen e fondeve për ndihmë sociale, tarifën e energjisë elektrike që ai ka të drejtë të përdorë ligjërisht, e cila është bllokuar sipas lëndës me numër. I. Nr. ----- nga 2001.

Bazuar në të gjitha rrethanat dhe të dhënat e përfshira në denoncimin në fjalë, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, nga aspekti i kompetencave të Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit në denoncimin e lëndës përcaktoi se ai nuk përmban elemente të veprimit kompetent në përputhje me nenin 17 nga Ligji për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit.

Duke pasur parasysh të theksuarën e mësipërme, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit vendosi si në dispozitën e këtij vendimi.

KOMISIONI SHTETËRO
PËR PARANDALIMIN E
KORRUPSIONIT
Kryetar,
Biljana Ivanovska

Dorëzuar deri te:
Arkivi
Parashtruesi

Përgatiti: M.r K.Z, Këshilltar
Miratoi: SPD, Anëtar i KSHPK-së

